





REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO		
 		
Procedura e Kosovës Institution of Kosovo		
Oda e Infermierëve amantëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskoh satarë, babica i ostalih zdravstvenih struènjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV · ARHIV · ARCHIVE		
Nr. Prot. Eroj. prot. Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. page.	Data: Datum Date:
605	- 2 -	01.07.2019
PRISTINE · PRISTINA · PRISTINA		

**Memorandum i Mirëkuptimit
në mes të
Rrjetit të Edukatorëve Bashkëmohatarë (PEN)
dhe
Odës së infermierëve të Kosovës (OIK)**

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë (PEN) me mbështetje nga UNFPA Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara-Agjencion i Kombeve të Bashkuara për Shëndetin dhe të Drejtat Riprodhuese zyra në Kosovë, prej muajit Korrik 2019 është në zbatim të projektit “Angazhimin e Burrave në Atësi, Përkujdesje, dhe në Shëndetin Amënor dhe të Fëmijëve” në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Projekti synon praktikat më të mira në angazhimin e burrave në shëndetin amënor dhe të fëmijëve, në përkujdesje, dhe parandalimin e dhunës kundër grave dhe fëmijëve, përmes lëndëve të barazisë gjinore. Edhe pse fokusi kryesor i Programit është angazhimi i burrave përmes sektorit të shëndetit publik, po ashtu ofron mjete dhe burime për individë dhe organizata që duan të punojnë më përgjithësisht me burra si përkujdesës dhe baballarë për të parandaluar dhunën kundër fëmijëve dhe grave dhe të promovojnë barazinë gjinore. Objektivat kryesore të programit: Promovimin e barazisë gjinore brenda raporteve të çiftëve, definuar nga ndarje e barabartë e detyrave në përkujdesje dhe punë të shtëpisë; T’i ofroj sektorit të shëndetit publik mjete të nevojshme për të promovuar përfshirjen edhe të nënave edhe të baballarëve në shëndetin amënor dhe të fëmijëve; Të përmirësoj vetëbesimin dhe efikasitetin e burrave në përkujdesje që fëmija të zhvillohet dhe të zhvillohet mirë; Të promovoj raporte pozitive dhe të shëndosha prindërore me fëmijët duke refuzuar ndëshkimin trupor për ta dhe forma të tjera të dhunës kundër tyre; Të parandaloj dhunën ndaj grave dhe të promovon raporte të shëndosha dhe të lumtura; T’i inkurajoj çiftet që t’iu mësojnë vlerat e barazisë gjinore fëmijëve dhe të jenë model të barazisë së tillë në raportet e tyre.

Qëllimi dhe angazhimi

Përmes këtij memorandum i synohet që të përkufizohen dhe sqarohen mënyrat dhe kohëzgjatja e bashkëpunimit në mes të OJQ PEN dhe Odës së infermierëve të Kosovës (OIK). Programi është përmbledhje e strategjike dhe hapa veprues të ndërlidhur të hartuar për të riformësuar atë se si komunitetet lokale dhe qeveritë, posaçërisht sistemi i shëndetit publik, i angazhon burrat si përkujdesës. Manuali përmban 3 seksione ku secili ofron dëshmi, udhëzime, dhe mjete të dobishme për t’i angazhuar burrat në mënyrë më të barabartë si baballarë dhe përkujdesës për një audiencë të caktuar.

Kontributi i Odës së infermierëve të Kosovës (OIK) synohet të jetë si në vijim:

- Brenda mundësive të mbështetë aktivitetet e projektit.
- Të mbështesë përpjekjet e organizatës PEN lidhje me përzgjedhjen e infermiereve shëndetësorë rreth Angazhimit të Baballarëve - Atësia në Sektorin Shëndetësor.
- Bashkëpunimi lidhje me trajnimin me profesionistët shëndetësor që ofrojnë kujdes të shëndetit amënor dhe të fëmijëve, ku përfshihen këshilla dhe mjete për inkorporimin e protokolleve në angazhimin e baballarëve brenda sektorit shëndetësor.
- Të ndihmoj në identifikimin e pjesëmarrësve në trajnimin tre ditorë të infermierëve të Kosovës.
- Të ofroj hapësirë për organizimin dhe mbajtjen e këtyre trajnimeve që janë paraparë me rreth 20 infermierë/e.

Kohëzgjatja e MiM

Ky MiM do të zgjasë deri më Dhjetor 2019, përgjatë procesit të zbatimit të aktiviteteve të projektit.

Ndërprerja e MiM

Në rastet kur njëra palë dëshiron të ndërpresë këtë memorandum, njoftimi duhet të bëhet të paktën dy (2) javë më herët dhe në mënyrë të shkruar.



z. Bujar Fejzullahu
PEN - Drejtor Ekzekutiv



z. Naser Rrustemaj
Kryetar OIK